Vendim nr. 91, datë 08.10.2026

(V- 91/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datat 22.09.2026 dhe 08.10.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 22 (K) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **KLITON SPAHIU, PETRIT ÇENO, PETRAQ DHIMITRI**

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga prokurori Klodian Braho.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-773, datë 14.05.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

Konstatimi i tejzgjatjes së procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe gjatë hetimeve paraprake.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë ose në një nga gjykatat e faktit: Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Njohja dhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera nga kërkuesit Kliton Spahiu dhe Petrit Çeno në Gjykatën Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 30, 31, shkronja "d", 32, pika 2, 42, pika 2, 124, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta)*; nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*); nenet 339/2, pika 1, shkronjat "ç" dhe "d", si dhe 399/10 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); nenet 2, 3, 4, 15, 17, 18, 327, pika 4, 331, pika 2, dhe 405, pika 7, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).**

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve Kliton Spahiu, Petrit Çeno, Petraq Dhimitri (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit kanë ushtruar detyrën e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Në muajin shkurt 2015 ata kanë gjykuar një çështje civile me palë paditëse tre shtetas dhe të paditur shtetasin N.S. Nga rrethanat ka rezultuar se gjatë kohës që kjo çështje ishte në pritje për t'u gjykuar në Gjykatën e Apelit Durrës, kërkuesit së bashku me palën e paditur, shtetasin N.S., dhe shtetasin A.Sh. (mik i kërkuesit Petraq Dhimitri), kanë udhëtuar në Itali në datat 02.10.2014-05.10.2014. Ky i fundit rezulton të ketë bërë edhe pagesën e biletave të udhëtimit për në Itali (*episodi i parë*). Po kështu, në datat 24.10.2014-26.10.2014 kërkuesit kanë udhëtuar në Spanjë (*episodi i dytë*), ndërsa pagesa e qëndrimit të tyre në hotel është bërë nga shtetasi F.P., punonjës i ambasadës së Shqipërisë në Spanjë, që ka lidhje krushqie me shtetasin N.S., i cili ka udhëtuar në të njëjtin destinacion në datat 23.10.2014-27.10.2014.

2. Në lidhje me këto ngjarje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka regjistruar procedimin penal të vitit 2015 në ngarkim të kërkuesve, për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 319/ç dhe 25 të Kodit Penal (*KP*). Në datën 23.11.2018 prokuroria ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, e cila është pranuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda së bashku me kërkesën e kërkuesve për gjykim të shkurtuar.

3. Për sa i përket procesit civil, me palë të paditur shtetasin N.S., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1302, datë 14.05.2013, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim shtetasi N.S. Me vendimin nr. 10-2015-387 (160), datë 18.02.2015, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1302, datë 14.05.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rrëzimin e padisë së paditësve, si të pabazuar në ligj dhe në prova. Kjo çështje gjyqësore rezulton se është gjykuar nga kërkuesit Kliton Spahiu, Petrit Çeno dhe Petraq Dhimitri. Për rekursin e paditësve, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, me tjetër trup gjykues, me arsyetimin se ndaj anëtarëve të trupit gjykues të asaj gjykate ka filluar procedimi penal dhe më pas ata janë deklaruar fajtorë për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të kryer në bashkëpunim. Pra, ekziston dyshimi i arsyeshëm se vendimi është produkt i një procesi të dyshuar si i njëanshëm.

4. Lidhur me çështjen penale në ngarkim të kërkuesve, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 69, datë 29.10.2019, ka vendosur deklarimin fajtorë të tyre për veprën penale për të cilën akuzohen dhe dënimin me 3 vjet burgim, ndërsa në aplikim të nenit 406 të KPP-së, uljen e dënimit me 1/3-ën dhe dënimin përfundimtar të tyre me 2 vjet burgim, si dhe heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 vjet. Sipas kësaj gjykate, është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm se kërkuesit kanë përfituar në mënyrë të parregullt pagesën e biletave në Itali dhe të akomodimit në hotel në Spanjë nga shtetasi N.S. në këmbim të kryerjes së një veprimi që lidhej me detyrën, duke përmbushur kështu elementet e anës objektive të figurës së veprës penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarit, të prokurorit dhe të funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 19, datë 21.09.2020, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës

së shkallës së parë dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim për kërkuesit, duke i vendosur në afat prove për një periudhë prej 4 vjetësh, me kusht që të mos kryejnë vepër tjetër penale. Kjo gjykatë, me të njëjtin arsyetim si gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se vepra penale është kryer në bashkëpunim dhe se kërkuesit kanë zhvilluar një veprimtari korruptive, duke kërkuar përfitime personale nga njëra prej palëve në gjykim. Për sa i përket dënimit, ajo ka vlerësuar se ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 59 të KP-së për pezullimin e dënimit me burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria e Posaçme në datën 26.10.2020; kërkuesi Kliton Spahiu rekurs në datën 26.10.2020, shtesë rekursi në datën 13.01.2021 dhe memo me shkrim në datën 08.01.2025, ndërsa kërkuesi tjetër Petrit Çeno ka paraqitur rekurs në datën 02.11.2020 dhe kërkesë me shkrim në datën 11.04.2025, në të cilën ka kërkuar mospranimin e rekursit të prokurorisë. Po kështu, rezulton se kërkuesit kanë përfunduar dënimin alternativ të caktuar nga gjykata e apelit.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-773, datë 14.05.2025, ka vendosur mospranimin e rekurseve, me arsyetimin se ato nuk përmbanin asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

7. Në datën 10.10.2025 kërkuesit Kliton Spahiu dhe Petrit Çeno i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 29.12.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 16.01.2026, ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

8. Po kështu, në datën 15.09.2025 kërkuesi Petraq Dhimitri i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar të njëjtat vendime gjyqësore, i cili, pasi është plotësuar sipas parashikimeve të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 31.12.2025. Me vendimin e datës 04.03.2026 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Nisur nga fakti se kërkuesit në të dyja ankimet kushtetuese individuale kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna në të njëjtin proces gjyqësor, në të cilin ata janë dënuar për të njëjtën vepër penale, të kryer në bashkëpunim, dhe në thelb kanë ngritur të njëjtat pretendime me natyrë kushtetuese, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 11.03.2026, ka vendosur bashkimin e çështjeve, bazuar në nenin 1, paragrafi i dytë, të Ligjit Organik të Gjykatës, nenin 57 të KPC-së dhe nenin 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. ***Kërkuesit***, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet gjyqësore i kanë cenuar:

10.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, në drejtim të:

10.1.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi, *së pari*, gjyqtari E.Dh., i cili është pjesë e trupit gjykues që ka disponuar me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka disponuar me vendimin civil nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024 të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, me tjetër trup gjykues. Në këtë vendim trupi gjykues i është referuar një vendimi penal për fajësinë e kërkuesve, i cili ende nuk kishte marrë formë të prerë dhe cilësinë e *res judicata* dhe po kështu është i pasaktë për sa i përket arsyetimit të tij, në lidhje me faktet: udhëtimin më shumë se dy herë të kërkuesve dhe komunikimet e vazhdueshme të tyre. Ky fakt nuk është pranuar as nga organi i akuzës, për rrjedhojë është tregues i anshmërisë së gjyqtarit. Në këtë mënyrë gjyqtari E.Dh. ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes penale.

Së dyti, të tre gjyqtarët e trupit gjykues në GJKKO-në e Apelit kanë gjykuar me kërkuesit disa çështje penale ose civile në gjykime të mëparshme. Veçanërisht kërkuesi Petrit Çeno ka qenë në cilësinë e kryetarit të Gjykatës së Apelit Durrës dhe tre gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen e kërkuesve mund të kenë pasur pakënaqësi lidhur me organizimin e punës në këtë gjykatë, veçanërisht me titullarin e saj. Po kështu, gjyqtarja S.D. ka punuar me kërkuesin Petrit Çeno si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, pra në marrëdhënie jo të njëjta hierarkie, ku mund të ketë pasur pakënaqësi. Kërkuesi Kliton Spahiu ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares S.D., pasi ajo ka shprehur mendim për çështjen në prani të një kolegu tjetër, i cili ka lëshuar deklaratë me shkrim. Po në një rast tjetër, kërkuesi Kliton Spahiu ka pasur debate me këtë gjyqtare gjatë kohës që ishin kolegë për shkak të mendimit juridik të kundërt në gjykimin e çështjeve. Paragjykimi i kësaj gjyqtareje provohet në mendimin e saj në

pakicë, në të cilin ka kërkuar që të mos aplikohej neni 59 i KP-së. Pretendimet për paanshmëri për këtë gjyqtare kërkuesit mund t'i ngrenë në çdo kohë.

Gjithashtu, gjyqtarja N.K., kryesuese e trupit gjykues në GJKKO-në e Apelit, duhej të paraqiste dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjes, pasi ajo ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesve gjatë hetimeve paraprake dhe njëkohësisht ka shqyrtuar edhe çështjen e themelit, në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 2, të KPP-së.

Së treti, prokurorët e çështjes në të tria shkallët e gjykimit janë caktuar pa short dhe janë zëvendësuar shpesh, më shumë se 6-7 prokurorë dhe asnjëherë me kërkesën e kërkuesve. Një kërkesë e kërkuesve për përjashtimin e njërit prej prokurorëve nuk është pranuar, në ndryshim nga kërkesa e palës paditëse në procesin civil, pas së cilës prokurori ka kërkuar heqjen dorë dhe është pranuar nga titullari i prokurorisë.

10.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi nga ana e GJKKO-së së Apelit dhe Gjykatës së Lartë mungon arsyetimi i shkaqeve të parashtruara në ankim, kërkesa paraprake ose memorie, si dhe në rekurs, çka tregon se kërkuesit nuk janë dëgjuar. Gjykata e Lartë ka ngatërruar shkaqet e rekursit të të dy kërkuesve, duke cituar emrin e njërit prej tyre në shkaqet e parashtruara nga kërkuesi tjetër dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, duke cenuar në këtë mënyrë dhe *të drejtën e aksesit*. Gjykata e Lartë nuk është shprehur as për pretendimin e kërkuesve se në një rast të ngjashëm ajo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e apelit nuk kishte argumentuar mjaftueshëm parimin e prezumimit të pafajësisë në veprën penale të korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione në sistemin e drejtësisë. Gjykatat duhet të arsyetonin mekanizmin e pagesës së hotelit nga shtetasi N.S. te F.P, momentin dhe vendin ku është bërë kjo pagesë. Po kështu, gjykata e apelit nuk ka shqyrtuar pretendimet e paraqitura me shkrim nga kërkuesi Kliton Spahiu përpara fillimit të seancës gjyqësore për sa i përket pavlefshmërisë së akteve në gjuhën spanjolle, por ka deklaruar se do t'i trajtonte ato në vendimin përfundimtar,

në të cilin ka arsyetuar vetëm 15%-20% të kërkimeve. Edhe në Gjykatën e Lartë nuk kanë marrë përgjigje të gjitha kërkimet.

GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar ndonëse kërkuesi Kliton Spahiu ka pasur pretendime për pavlefshmërinë dhe papërdorshmërinë e provave të marra gjatë hetimit paraprak, të pretenduara edhe nga kërkuesi tjetër në ankim. Ajo gjykatë duhet të sqaronte qëndrimin e kërkuesit nëse ai do të hiqte dorë për njërën nga kërkesat dhe të vijonte me marrjen e provave me dëshmitarë për vetë faktin se ka deklaruar që deklarimet e dy dëshmitarëve janë të paqarta dhe evazive. Edhe GJKKO-ja e Apelit nuk e ka revokuar vendimin e pranimit të gjykimit të shkurtuar dhe nuk ka arsyetuar në lidhje me pretendimet e kërkuesve në këtë drejtim. Vetë kjo gjykatë ka pranuar për shqyrtim një provë të rëndësishme të organit të akuzës në gjuhën spanjolle, për të cilën ka konstatuar se është përkthyer gabim. Kërkuesi Kliton Spahiu ka kërkuar revokimin e vendimit të gjykatës për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar dhe ndonëse legjislacioni nuk ka parashikuar momentin kur mund të kërkohet ky revokim, ligji duhet të interpretohet në favor të të pandehurit. Prokuroria ka deklaruar se kërkuesit nuk kanë pasur paragjykim për provat e administruara, kur ky term nuk është parashikuar në ligj.

10.1.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjyqtarja I.Gj., e cila ka disponuar në gjykatën e shkallës së parë, rezulton e dënuar në shtetin grek dhe për këtë shkak nuk duhej të ishte në funksionin e gjyqtares. Kjo gjyqtare ka disponuar me vendimin në gjykatën e shkallës së parë në kundërshtim me parashikimet ligjore që përcaktojnë kushtet për të qenë gjyqtare. Po kështu, gjyqtarja I.Gj. ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar ndonëse nga kërkuesit ka pasur kërkesa për pavlefshmërinë e akteve, si dhe ajo ka qenë kontradiktore dhe ka mbështetur fajësinë në një provë indirekte.

10.1.4. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi për të njëjtat prova gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 436, datë 12.12.2017, ka rrëzuar kërkesat e prokurorisë për caktimin e masave të sigurimit me arsyetimin se nuk provohet dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi Petraq Dhimitri ka kryer vepër

penale. Sipas këtij vendimi, për të arritur në konkluzionin se kërkuesit kanë marrë përfitime të parregullta nga shtetasi N.S., nuk mjafton që ata kanë pasur komunikime, por kërkohet të ekzistojnë prova direkte ose indirekte që të provojnë dyshimin e arsyeshëm. E njëjta gjykatë nuk mund të mbajë dy qëndrime të ndryshme për vlerësimin e provave të sjella nga prokurori në mënyrë diametralisht të kundërt. Në këtë mënyrë gjykatat kanë deformuar vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011 për elementin e "dyshimit të arsyeshëm" për caktimin e masave të sigurimit dhe elementin e "bindjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" për themelin e akuzës.

10.1.5. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi procedimi penal dhe gjykimi i kërkuesve në të tria shkallët e gjykimit ka zgjatur 10 vjet. Vetëm në Gjykatën e Lartë gjykimi ka zgjatur 5 vjet. Edhe faza e hetimeve ka zgjatur 3 vjet dhe nuk konstatohen vendime për zgjatje të afatit të hetimeve. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal në datën 09.04.2015, ndërsa Prokuroria e Posaçme ka regjistruar emrat e personave që i atribuohej vepra penale (kërkuesve) pas 32 muajve, duke tejkaluar afatin e hetimeve.

10.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat nuk kanë përcaktuar qartësisht elementet e veprës penale, përgjegjësinë ligjore dhe shkallën e fajësisë për secilin nga kërkuesit, mekanizmin e kryerjes së veprës penale, vlerën e shumës që kanë përfituar të akuzuarit, faktin se përse nuk qëndron alibia e ngritur nga kërkuesi Kliton Spahiu se udhëtimet mund të jenë skemë e personave të tjerë pa dijeninë e kërkuesve. Çmuarja e provave del jashtë kompetencës së Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ajo duhet të kishte prishur vendimin dhe ta kthente çështjen për rigjykim në një nga gjykatat e faktit. Në rastin e kërkuesve, nuk është provuar se pagesa e shumës prej 441 eurosh është kryer nga shtetasi N.S., ndërsa ky i fundit nuk ka paguar as hotelin në të cilin është akomoduar vetë. Nuk është provuar gjithashtu se ai ka takuar shtetasin F.P. dhe i ka dhënë pagesën e hotelit. Kërkuesi Petrit Çeno në datat 02.10.2014-05.10.2014 nuk ka qenë në Itali. Ndërkohë, nga deklarimet e shtetasve E.Ç (djali i kërkuesit Petrit Çeno) dhe F.P. rezulton se shuma e pagesës është dhënë nga i pari, i cili është rimbursuar nga kërkuesit. Prokuroria nuk është

e qartë se për cilën vepër penale janë dënuar kërkuesit, pasi vendimet janë kontradiktore dhe të paqarta.

11. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

11.1. Pretendimi për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar. Konkretisht, në lidhje me paanshmërinë e gjyqtarit E.Dh. në Gjykatën e Lartë, referimi i një vendimi penal ekzistues në një vendim civil nuk përbën shprehje të bindjes paraprake të gjyqtarit mbi fajësinë dhe as paragjykim të çështjes. Gjykata civile ka të drejtë të marrë në konsideratë akte gjyqësore ekzistuese si fakte juridike, pavarësisht nëse janë përfundimtare, për sa kohë nuk u jep atyre efekt përfundimtar detyrues dhe nuk e bazon vendimmarrjen ekskluzivisht mbi to. Objekti i vendimit civil nuk ka qenë vlerësimi i fakteve penale të kërkuesve, por vlerësimi i natyrës juridike të mosmarrëveshjes civile dhe nevoja për përsëritjen e hetimit gjyqësor. Edhe pretendimi se kërkuesit nuk janë njoftuar nga Gjykata e Lartë për përbërjen e trupit gjykues nuk është i bazuar, për sa kohë kjo gjykatë ka shpallur datën e seancës dhe shtyrjen e saj, fakte të cilat u janë komunikuar kërkuesve nëpërmjet thirrjeve telefonike.

Për sa i përket pretendimit për paanshmërinë e trupit gjykues në gjykatën e apelit, ai është marrë në shqyrtim nga gjykata e apelit, e cila ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtares S.D. dhe, në vijim, i është nënshtruar kontrollit edhe nga Gjykata e Lartë.

Lidhur me gjyqtaren N.K., nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur kërkesë për dorëheqje sipas parashikimeve të ligjit procedural penal dhe nuk e kanë ngritur këtë pretendim as në gjykatat e zakonshme, për rrjedhojë ata nuk i kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion për të. Po kështu, nuk ekzistojnë fakte konkrete dhe shkaqe legjitime që mund të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve.

11.2. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka analizuar pretendimet e kërkuesve, duke u dhënë përgjigje atyre brenda shkaqeve të rekursit. Kjo gjykatë ka vepruar brenda diskrecionit të saj, si dhe ka parashtruar rrethanat e çështjes, arsyetimet e vendimeve të gjykatave të posaçme, analizën e ligjit procedural penal. Ajo u ka kthyer përgjigje edhe shkaqeve thelbësore të ngritura në ankim dhe të

përsëritura në rekurs, duke përmbushur standardin e arsyetimit të vendimit. Në këtë mënyrë, gjykatat kanë respektuar të drejtën e aksesit, duke i dhënë zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes dhe duke u dhënë përgjigje pretendimeve si në aspektin formal, ashtu edhe në aspektin substancial.

11.3. Për sa i përket vendimit të ndërmjetëm për pranimin e kërkesës për zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, gjykatat kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor duke pranuar kërkesat për gjykim të shkurtuar dhe arsyetuar se hetimet janë të plota dhe nuk konstatohen akte të pavlefshme ose të papërdorura. Gjykata e Lartë i ka trajtuar dhe i ka analizuar pretendimet e tyre në raport me ligjin procedural penal për këtë rit gjykimi. Gjykimi i shkurtuar nuk realizohet automatikisht vetëm me kërkesën e të pandehurit, por kërkon edhe miratimin e gjyqtarit. Pretendimet për analizimin e provave, zbatimin e ligjit, parimin e prezumimit të pafajësisë nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

11.4. Pretendimi për cenimin e së *drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk qëndron, pasi vlerësimi i kushteve të emërimit dhe konstatimi i pazgjedhshmërisë së një gjyqtari përbën kompetencë të Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*) dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (*ILD*) dhe Prokuroria e Posaçme nuk gëzon legjitimitet për të mbajtur qëndrim për sa kohë nuk ekziston një vendim përfundimtar nga organet përkatëse që ka deklaruar papajtueshmërinë e saj me detyrën e gjyqtarit. Gjykata Kushtetuese nuk mund të konstatojë vetë papajtueshmërinë e gjyqtares, për sa kohë kjo nuk bën pjesë në juridiksionin e saj. Gjithashtu, kërkuesit nuk kanë identifikuar prova të administruara në formën e kërkuar nga ligji, të cilat t'i jenë nënshtruar shqyrtimit nga organet e sistemit të drejtësisë për të mbështetur pretendimet e tyre.

11.5. Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* nuk është i bazuar, pasi ndryshimi i vendimmarrjeve nuk rrjedh nga një kontradiktë e pajustifikuar, por nga natyra e procedimit penal dhe mënyra sesi gjykata ka vlerësuar provat në faza të ndryshme procedurale. Vendimet e referuara nga kërkuesi Petraq Dhimitri u përkasin fazave të ndryshme të procedimit dhe vlerësimi i bërë në fazën e caktimit të masës së sigurimit nuk pengon një vlerësim të ndryshëm të provave në vijim të procesit.

11.6. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm* është i pabazuar. Për sa i përket fazës hetimore, nga aktet e dosjes evidentohen akte që lidhen me kërkesat e palëve për përjashtime të prokurorëve dhe vendime për zgjatje afati, dhe kohëzgjatja e hetimit ka qenë e nevojshme për shkak të dinamikës së tij, diskrecionit të prokurorisë dhe sjelljes së kërkuesve. Lidhur me argumentin e vonesës në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente që të tregojnë se atyre u është shkaktuar dëm nga kjo vonesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

12. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret e pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund t'i drejtohet Gjykatës për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

13. Duke pasur parasysh natyrën kumulative të kritereve të pranueshmërisë së kërkesës dhe jurisprudencën e saj, Gjykata vëren se kriteri i legjitimimit *ratione personae* të kërkuesve dhe *ratione temporis* të kërkesës janë të përmbushura. Në lidhje me to, nuk rezulton të ketë çështje që kërkojnë analizë të mëtejshme, ndërsa as subjekti i interesuar nuk ka ngritur ndonjë prapësim.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky kriter kërkon që kërkuesi të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve

juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar, ndër të tjera, cenimin e së *drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* me argumentin se procedimi penal dhe gjykimi i kërkuesve në të tria shkallët e gjyqësorit ka zgjatur 10 vjet, ndërsa vetëm në Gjykatën e Lartë gjykimi ka zgjatur 5 vjet. Po kështu, ata kanë pretenduar se edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal në datën 09.04.2015, ndërsa Prokuroria e Posaçme ka regjistruar emrat e personave që i atribuohej vepra penale (kërkuesve) pas 32 muajve, duke tejkaluar afatin e hetimeve. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se nga aktet e dosjes evidentohen akte që lidhen me kërkesat e palëve për përjashtime të prokurorëve dhe vendime për zgjatje afati, dhe kohëzgjatja e hetimit ka qenë e nevojshme për shkak të dinamikës së tij, diskrecionit të prokurorisë dhe sjelljes së kërkuesve. Lidhur me argumentin e vonesës në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, sipas këtij subjekti, kërkuesit nuk kanë parashtruar argumente që të tregojnë se u është shkaktuar dëm nga kjo vonesë.

16. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata sjell në vëmendje se KPC-ja prej vitit 2017, në nenet 399/1 e vijues ka parashikuar mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e së drejtës kushtetuese për gjykim brenda afatit të arsyeshëm. Lidhur me këto mjete, Gjykata ka pohuar se individi duhet t'u drejtohet fillimisht gjykatave të zakonshme dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen prej tyre, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues *(shih vendimet nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në rastin konkret, nuk rezulton që kërkuesit të kenë paraqitur kërkesë në gjykatat e zakonshme për konstatimin e shkeljes sipas dispozitave të KPC-së. Për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm ata nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, ndër të tjera, me argumentin se gjyqtari E.Dh., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka disponuar me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka dhënë vendimin civil të kësaj gjykate, duke vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit, Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, me tjetër trup gjykues. Në këtë vendim, sipas kërkuesve, trupi gjykues i është referuar një vendimi penal për fajësinë, i cili ende nuk kishte marrë formë të prerë dhe cilësinë e *res judicata* dhe, po kështu,

ka qenë i pasaktë për sa i përket arsyetimit të tij në lidhje me faktet (udhëtimin më shumë se dy herë të kërkuesve dhe komunikimet e vazhdueshme të tyre).

18. Sipas subjektit të interesuar, pretendimi se kërkuesit nuk janë njoftuar nga Gjykata e Lartë për përbërjen e trupit gjykues nuk është i bazuar për sa kohë kjo gjykatë ka shpallur datën e seancës dhe shtyrjen e saj, fakte të cilat u janë komunikuar kërkuesve nëpërmjet thirrjeve telefonike.

19. Lidhur me këtë pretendim, në datën 22.09.2026 Gjykata iu është drejtuar kërkuesve me shkresë në lidhje me momentin e marrjes dijeni prej tyre të vendimit nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në përgjigje të saj, kërkuesit kanë parashtruar se në kushtet kur nuk kanë qenë në cilësinë e palës në proces, ky vendim nuk u është komunikuar atyre zyrtarisht dhe nuk kanë pasur mundësi ta tërheqin atë.

20. Në këto kushte, Gjykata vëren se nuk rezulton e provuar që kërkuesit të kenë marrë dijeni për vendimin civil të Gjykatës së Lartë përpara shqyrtimit të çështjes së tyre penale nga kjo gjykatë. Po kështu, duke pasur parasysh se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë lidhet me procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, Gjykata vlerëson se në rrethanat konkrete nuk rezulton të ketë ndonjë çështje për diskutim për sa i përket përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive në lidhje me këtë pretendim.

21. Gjithashtu, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, edhe për shkak se gjyqtarja N.K. ka shqyrtuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj tyre dhe njëkohësisht ka shqyrtuar edhe çështjen e themelit në gjykatën e apelit. Lidhur me këtë shkak, Gjykata konstaton se, ndonëse ai lidhet me një nga rastet e papajtueshmërisë të parashikuara shprehimisht nga neni 15, pika 2, i KPP-së, nuk rezulton që kërkuesit ta kenë ngritur këtë pretendim përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, qoftë nëpërmjet kërkesës për përjashtimin e gjyqtares, qoftë si shkak ankimi ose rekursi, duke mos u dhënë atyre mundësinë për ta shqyrtuar këtë pretendim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

22. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkuesit i kanë ngritur më parë përpara gjykatave të zakonshme në formë dhe në përmbajtje, duke përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion. Në këto kushte, ata nuk kanë mjete të tjera në dispozicion përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

23. Gjithashtu, Gjykata konstaton se pas kalimit të çështjes në seancë plenare (16.01.2026), kërkuesit kanë depozituar parashtrimet e datës 16.02.2026, në të cilat kanë ngritur edhe pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, me argumentin se gjyqtarja I.Gj., e cila ka disponuar në gjykatën e shkallës së parë, rezulton e dënuar në shtetin grek dhe për këtë shkak nuk duhej të ishte në funksionin e gjyqtares. Po kështu, sipas kërkuesve, gjyqtarja I.Gj. ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar ndonëse nga kërkuesit ka pasur kërkesa për pavlefshmërinë e akteve, si dhe ajo ka qenë kontradiktore dhe ka mbështetur fajësinë në një provë indirekte.

24. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se vlerësimi i kushteve të emërimit dhe konstatimi i pazgjedhshmërisë së një gjyqtari përbën kompetencë të KLGJ-së dhe të ILD-së dhe Gjykata nuk mund të konstatojë vetë papajtueshmërinë e gjyqtares, për sa kohë kjo nuk bën pjesë në juridiksionin e saj. Gjithashtu, kërkuesit nuk kanë identifikuar prova të administruara në formën e kërkuar nga ligji të cilat t'i jenë nënshtruar shqyrtimit nga organet e sistemit të drejtësisë për të mbështetur pretendimet e tyre.

25. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se, në mbështetje të nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të saj dhe nenit 185 të KPC-së, shkaqet e ankimit kushtetues individual mund të ndryshohen (të shtohen ose të pakësohen), deri në momentin që vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih vendimet nr. 28, datë 11.04.2024; nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Pavarësisht këtij standardi, Gjykata çmon të mos ndalet në këtë çështje, pasi vlerëson se pretendimi është gjithsesi haptazi i pabazuar. Konkretisht, çështja që ngrihet nga kërkuesit ka të bëjë me faktin se gjyqtarja I.Gj. ka qenë në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit për shkak të ligjit, ndaj ushtrimi i tij, në rastin konkret, ka cenuar parimin e gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Megjithatë, Gjykata vëren se nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga ajo gjyqtare për shkakun e pretenduar nga kërkuesit ose për ndonjë shkak tjetër ligjor. Në këtë kuptim, gjyqtarja në fjalë, për sa ka qenë në detyrë, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve në rastin konkret dhe, për pasojë, pretendimi i kërkuesve është i pabazuar.

26. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *parimit të paanshmërisë, parimit të sigurisë juridike, së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit* si në drejtim të vendimeve gjyqësore në tërësi, ashtu edhe për sa i përket kërkesës për gjykim të shkurtuar, si dhe *parimit të prezumimit të pafajësisë*.

27. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të paanshmërisë*, Gjykata konstaton se kërkuesit kanë ngritur tre shkaqe kryesore: (i) gjyqtari E.Dh., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka disponuar me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka disponuar me vendimin civil të kësaj gjykate, duke iu referuar vendimit të fajësisë së kërkuesve, i cili nuk kishte marrë formë të prerë; (ii) gjyqtarët në gjykatën e apelit kanë gjykuar disa çështje së bashku me kërkuesit dhe mund të kenë pasur pakënaqësi ndaj tyre, si dhe gjyqtarja S.D. ka pasur debate me kërkuesin Kliton Spahiu; (iii) prokurorët e çështjes janë caktuar pa short dhe janë zëvendësuar shpesh.

28. Për sa i përket shkakut të dytë, Gjykata vëren se kërkuesit kanë ngritur dyshime për paanshmërinë e gjyqtares S.D., duke iu referuar marrëdhënieve të mëparshme profesionale me të, debateve të zhvilluara gjatë ushtrimit të funksionit, si dhe qëndrimeve të saj për çështjen objekt gjykimi. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se vetëm fakti i ekzistencës së marrëdhënieve të mëparshme profesionale ose hierarkike, si dhe i debateve me karakter profesional, nuk është i mjaftueshëm, në vetvete, për të krijuar dyshime objektivisht të justifikuara për paanshmërinë e gjyqtares. Po kështu, shprehja e një qëndrimi juridik në një mendim pakice, në kuadër të ushtrimit të funksionit gjyqësor, nuk përbën, në vetvete, tregues të paragjykimit të çështjes. Për sa i përket pretendimit se gjyqtarja S.D. ka shprehur paraprakisht mendim për çështjen, Gjykata vëren se deklarata me shkrim e gjyqtarit A.V. konfirmon zhvillimin e një diskutimi për çështje procedurale që lidheshin me procedimin penal ndaj kërkuesit Kliton Spahiu, por nga përmbajtja e saj nuk rezulton që gjyqtarja të ketë mbajtur një qëndrim të tillë që të krijojë dyshime objektivisht të justifikuara për paanshmërinë e saj. Për më tepër, Gjykata sjell në vëmendje se ky kërkues ka kërkuar përjashtimin e gjyqtares S.D., kërkesë që është rrëzuar nga gjykatat deri në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka vlerësuar se fakti që kërkuesi dhe gjyqtarja kanë qenë pjesë e trupave gjykues në ushtrim të detyrës për shkak të delegimeve reciproke, nuk përbën rast papajtueshmërie sipas nenit 78 të KPP-së, arsyetim i cili nuk duket të jetë arbitrar. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se argumentet e parashtruara nga kërkuesit nuk janë të mjaftueshme për të vënë në dyshim, nga pikëpamja kushtetuese, paanshmërinë e gjyqtares S.D.

29. Në lidhje me shkakun e tretë, sipas të cilit është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi prokurorët e çështjes janë caktuar pa short dhe janë zëvendësuar shpesh, Gjykata vëren se kërkuesit nuk kanë arritur të paraqesin argumente kushtetuese në mbështetje të këtij pretendimi, duke mos shpjeguar se në çfarë mënyre caktimi pa short ose zëvendësimet e prokurorëve kanë sjellë cenimin

konkret të garancive kushtetuese të procesit të tyre gjyqësor. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

30. Po kështu, Gjykata evidenton se kërkuesi Petraq Dhimitri ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, me argumentin se për të njëjtat prova gjyqtari i hetimeve paraprake ka arsyetuar se nuk provohet dyshimi i arsyeshëm në kryerjen e veprës penale, ndërsa e njëjta gjykatë për themelin e akuzës ka mbajtur qëndrim të ndryshëm për vlerësimin e provave të sjella nga prokurori. Sipas kërkuesit, gjykatat kanë deformuar vendimin unifikues për elementin e "dyshimit të arsyeshëm" dhe "bindjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm". Subjekti i interesuar ka prapësuar se ky pretendim nuk është i bazuar, pasi ndryshimi i vendimmarrjeve nuk rrjedh nga një kontradiktë e pajustifikuar, por nga natyra e procedimit penal dhe mënyra sesi gjykata ka vlerësuar provat në faza të ndryshme procedurale. Sipas këtij subjekti, vendimet e referuara nga kërkuesi Petraq Dhimitri u përkasin fazave të ndryshme të procedimit dhe vlerësimi i bërë në fazën e caktimit të masës së sigurimit nuk pengon një vlerësim të ndryshëm të provave në vijim të procesit. Po kështu, sipas subjektit të interesuar, ky pretendim ka marrë përgjigje nga gjykatat.

31. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal dhe ai për zgjidhjen në themel të akuzës penale u përkasin fazave të ndryshme të procedimit penal, kanë objekt dhe standarde të ndryshme për vlerësimin e provave. Për rrjedhojë, vlerësimi i bërë nga gjyqtari i hetimeve paraprake për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm nuk ka karakter përfundimtar për çështjen e fajësisë dhe nuk pengon gjykatën që shqyrton çështjen në themel të arrijë në një përfundim të ndryshëm në bazë të vlerësimit të provave gjatë gjykimit. Në këto kushte, vetëm fakti i ekzistencës së vlerësimeve të ndryshme në këto dy faza të procedimit nuk përbën, në vetvete, cenim të parimit të sigurisë juridike. Ndërsa për sa u përket argumenteve që lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave dhe përmbushjen e standardit të provueshmërisë së fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, Gjykata çmon t'i trajtojë ato në drejtim të *parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*.

32. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkuesve, për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*, nisur nga thelbi dhe përmbajtja e pretendimeve, Gjykata vlerëson t'i analizojë në dy drejtime, të lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe me parimin e prezumimit të pafajësisë, të cilat së bashku me *parimin e paanshmërisë* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të paanshmërisë

33. Kërkuesit kanë pretenduar se gjyqtari E.Dh., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka disponuar me vendimin e Gjykatës së Lartë, objekt kundërshtimi, ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka disponuar me vendimin civil nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024 të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, me tjetër trup gjykues. Sipas tyre, në këtë vendim, trupi gjykues i është referuar një vendimi penal për fajësinë e kërkuesve, i cili ende nuk kishte marrë formë të prerë dhe po kështu është i pasaktë për sa i përket arsyetimit të tij në lidhje me faktet: udhëtimet më shumë se një herë të kërkuesve dhe komunikimet e vazhdueshme të tyre.

34. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se referimi i një vendimi penal ekzistues në një vendim civil nuk përbën shprehje të bindjes paraprake të gjyqtarit mbi fajësinë dhe as paragjykim të çështjes. Sipas tij, gjykata civile ka të drejtë të marrë në konsideratë akte gjyqësore ekzistuese si fakte juridike pavarësisht nëse janë përfundimtare, për sa kohë nuk u jep atyre efekt përfundimtar detyrues dhe nuk e bazon vendimmarrjen ekskluzivisht mbi to. Objekti i vendimit civil nuk ka qenë vlerësimi i fakteve penale të kërkuesve, por vlerësimi i natyrës juridike të mosmarrëveshjes civile dhe nevoja për përsëritjen e hetimit gjyqësor.

35. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se në kuptim të nenit 42, pika 2, të Kushtetutës, respektimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, *testin subjektiv*, i cili, në thelb, kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe gjithashtu *testin objektiv*, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm *(shih vendimet nr. 35, datë 25.04.2024; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese).*

36. Gjykata ka theksuar se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet edhe në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimet nr. 77, datë*

23.06.2026; nr. 15, datë 26.03.2012; nr. 12, datë 13.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij, por ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit për çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar për paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel (*shih vendimet nr. 77, datë 23.06.2026; nr. 25, datë 11.06.2013*; *nr. 16, datë 19.04.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në vlerësimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), sipas testit objektiv, duhet përcaktuar nëse, pavarësisht nga sjellja personale e gjyqtarit, ekzistojnë fakte të verifikueshme që mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e tij. Në këtë drejtim, edhe dukja e jashtme mund të ketë një rëndësi të caktuar. Ajo që ka rëndësi është besimi që gjykatat, në një shoqëri demokratike, duhet të ngjallin te publiku dhe, mbi të gjitha, tek i pandehuri. Kjo nënkupton se, kur vlerësohet nëse në një rast të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i të pandehurit është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Elementi vendimtar është nëse kjo frikë mund të konsiderohet objektivisht e justifikuar (*shih Fatullayev kundër Azerbajxhanit, 22.04.2010, § 139; Fey kundër Austrisë, datë 24.02.1993, § 30*).

38. Në referim të standardeve të mësipërme, Gjykata do të analizojë nëse Gjykata e Lartë, pjesë e së cilës ishte gjyqtari E.Dh., për të cilin kanë ngritur pretendime kërkuesit, ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim, nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë në dhënien e vendimit të mospranimit të rekursit dhe nëse dyshimi i kërkuesve është objektivisht i justifikueshëm.

39. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjyqtari E.Dh., i cili është pjesë e trupit gjykues që ka disponuar me vendimin e Gjykatës së Lartë objekt kundërshtimi, ka marrë pjesë edhe në trupin gjykues që ka disponuar me vendimin nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, me tjetër trup gjykues. Sipas përmbajtjes së këtij të fundit, Gjykata vëren se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka theksuar se funksioni i saj rishikues ushtrohet pa i hyrë analizës së provave, ka vlerësuar se gjykata e apelit ka lejuar shkelje të normave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit dhe se anëtarët e trupit gjykues kanë pasur pengesë ligjore për të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje. Kjo për shkak se ndaj tyre ka filluar procedimi penal për lidhje të ngushta shoqërore me të padituriin N.S. dhe se gjatë kohës që çështja ka qenë në pritje

për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës kanë pasur takime të vazhdueshme me të padituri N.S., kanë shkëmbyer telefonata të vazhdueshme me njëri-tjetrin dhe jo vetëm kaq, por edhe kanë udhëtuar për më tepër se dy herë jashtë shtetit të gjithë së bashku. Po sipas këtij kolegji, këto pretendime rezulton të jenë vërtetuar gjyqësisht dhe kërkuesit janë deklaruar fajtorë e dënuar për kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve me vendimin nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në përfundim, Kolegji Civil ka vlerësuar se ekziston një dyshim i justifikuar te rekursuesi, shtetasi O.U., se vendimi i dhënë është produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm, që përbën cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme. Për rrjedhojë, sipas Kolegjit Civil, vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet për rishqyrtim kësaj gjykate, me tjetër trup gjykues. Gjykata e apelit në rigjykim duhet të përsërisë hetimin gjyqësor dhe të përcaktojë me vendim për secilën palë faktet që duhet të provohen prej tyre, provat që lejohen të paraqiten nga secila palë veçmas, vlerën provuese të secilës provë, si dhe barrën e provës për secilën palë.

40. Gjykata vëren se nga përmbajtja e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se gjyqtari E.Dh. ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë në datën 31.01.2025, e cila është refuzuar nga kryetari i kësaj gjykate me vendimin e datës 25.02.2025. Referuar këtij vendimi, vetëm fakti që gjyqtari ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi për një çështje civile, e cila është prishur dhe kthyer për rigjykim për shkak të pretendimeve të lidhura me procedimin penal objekt rekursi, nuk vlerësohet automatikisht se është i asaj natyre sa të konsiderohet një shkak serioz njëanshmërie. Po kështu, nuk rezultojnë shkaqe të përligjura se ky gjyqtar është në pamundësi për ta garantuar gjykimin e paanshëm në aspektin objektiv dhe subjektiv, pasi ai nuk rezulton të ketë mbajtur qëndrim mbi fajësinë ose pafajësinë e kërkuesve, por ka vlerësuar referuar ekzistencës së një vendimi gjyqësor parregullsitë e një procesi gjyqësor në drejtim të pretendimit për anshmërinë në dukje të gjyqtarit. Sipas këtij vendimi, arsyet serioze të njëanshmërisë së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë nuk kanë vend kur ky pretendim lidhet me "çmuarjen ose vlerësimin e akteve (provave)", përveç rastit kur i njëjti gjyqtar i Gjykatës së Lartë ka qenë më parë gjyqtar ose prokuror në fazën e shqyrtimit në themel të së njëjtës çështjeje gjyqësore. Kjo për arsye se, si veprimtari "paragjykuese", në kuptim të "arsyeve serioze të njëanshmërisë", kuptohet ajo veprimtari që përfshin një vlerësim në themel (meritë) të akuzës ose një mase ndaj lirisë personale, ndërkohë që gjykimi në Gjykatën e Lartë ka për qëllim kontrollin e ligjshmërisë dhe jo vlerësimin e çështjes në themel. Për rrjedhojë, sipas vendimit, fakti

i evidentuar nga gjyqtari nuk përbën njëanshmëri as në dukje, por ushtrim të atributeve si gjyqtar nga ana e tij në shqyrtimin e çështjes civile në fjalë si anëtar i Kolegjit Civil, në përputhje me atributet si gjykatë ligji dhe jo themeli (atribut i së cilës është vlerësimi i akteve/provave të administruara në proces).

41. Në këto rrethana, Gjykata vëren se pretendimi i kërkuesve, në thelb, lidhet me faktin nëse vlerësimet e gjyqtarit E.Dh., të pasqyruara në vendimin civil, janë të tilla që mund të ndikojnë në perceptimin e paanshmërisë së tij në shqyrtimin e rekurseve të tyre nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se, pavarësisht se të dyja proceset gjyqësore kanë pasur objekte dhe natyra të ndryshme, rëndësi merr përmbajtja e vlerësimeve të bëra në vendimin civil dhe lidhja e tyre me rrethanat faktike të akuzës penale ndaj kërkuesve. Konkretisht, Kolegji Civil ka vlerësuar se gjykata e apelit kishte lejuar shkelje procedurale që kishin ndikuar në dhënien e vendimit dhe se anëtarët e trupit gjykues kishin pasur pengesë ligjore për të marrë pjesë në gjykimin e çështjes (*shih paragrafët 122–123 të vendimit nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024 të Kolegjit Civil*). Në vijim, Kolegji Civil ka konstatuar se ndaj kërkuesve kishte filluar procedimi penal për lidhje të ngushta shoqërore me të padituri në procesin civil dhe se, gjatë kohës që çështja ishte në pritje për shqyrtim në gjykatën e apelit, si dhe pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, ata kishin pasur takime të vazhdueshme me të padituri, kishin shkëmbyer telefonata të vazhdueshme dhe kishin udhëtuar më shumë se dy herë jashtë shtetit të gjithë së bashku (*shih paragrafin 124 të vendimit të Kolegjit Civil*). Po kështu, Kolegji Civil ka pohuar se të gjitha këto pretendime rezultonin të vërtetuara gjyqësisht, duke iu referuar vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë me të cilin kërkuesit ishin deklaruar fajtorë dhe dënuar për kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv të gjyqtarëve (*shih paragrafin 125 të vendimit të Kolegjit Civil*). Mbi këtë bazë, Kolegji Civil ka vlerësuar se ekzistonte një dyshim i justifikuar te rekursuesi se vendimi i gjykatës së apelit ishte produkt i një procesi të dyshuar si të njëanshëm, çka cenonte besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme (*shih paragrafin 126 të vendimit të Kolegjit Civil*).

42. Në analizë të këtij vendimi, Gjykata evidenton se ndonëse Kolegji Civil, ku bënte pjesë gjyqtari E.Dh., nuk ka kryer një shqyrtim në themel të akuzës penale dhe nuk ka rivlerësuar provat e administruara në procesin penal, konstatimet e bëra në vendimin civil nuk janë kufizuar vetëm në referimin e ekzistencës së një procedimi ose vendimi penal. Kolegji Civil i ka trajtuar si të vërtetuara gjyqësisht rrethanat faktike që lidheshin drejtpërdrejt me akuzën penale dhe që kishin rëndësi edhe për përfundimin e tij lidhur me paanshmërinë e gjyqtarëve të çështjes civile. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se, ndonëse konstatimet e bëra në vendimin civil kanë qenë në

funksion të zgjidhjes së një mosmarrëveshjeje civile dhe jo të përcaktimit të përgjegjësisë penale të kërkuesve, rëndësi merr fakti se gjyqtari E.Dh. ka marrë pjesë më pas në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, i cili kishte për shqyrtim rekurset kundër vendimeve penale që mbështeteshin në të njëjtat rrethana faktike. Në këto kushte, Gjykata çmon se pjesëmarrja e këtij gjyqtari në shqyrtimin e rekurseve penale është e tillë që mund të krijojë dyshime për paanshmërinë e tij.

43. Në këtë drejtim, edhe GJEDNJ-ja ka vlerësuar se pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në procese civile dhe penale që lidhen me të njëjtat fakte nuk cenon domosdoshmërisht paanshmërinë, por rëndësi kanë rrethanat konkrete të çështjes dhe, në veçanti, nëse gjyqtari ka bërë më parë vlerësime për fakte që duhet t'i shqyrtojë sërish në procesin penal *(shih Fatullayev kundër Azerbajxhanit, datë 22.04.2010, §§ 138–139)*. Për rrjedhojë, nisur nga natyra dhe nga përmbajtja e konstatimeve të bëra në vendimin civil, si dhe lidhja e tyre me rrethanat faktike të akuzës penale, Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, vlerëson se dyshimet e kërkuesve për paanshmërinë e gjyqtarit E.Dh. në shqyrtimin e rekursit penal janë objektivisht të justifikuara. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të paanshmërisë është i bazuar.

44. Në kushtet kur, për arsyet e mësipërme, çështja duhet të merret sërish në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata, në respektim të parimit të subsidiaritetit, çmon të mos ndalet në analizimin e mëtejshëm të pretendimeve të tjera të kërkuesve për cenimin e *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit*, në dy drejtime, të lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe parimin e prezumimit të pafajësisë.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit

45. Kërkuesit Kliton Spahiu dhe Petrit Çeno kanë kërkuar gjithashtu rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore, bazuar në nenin 28, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës për sa u përket shpenzimeve të kryera për mbledhjen e provave, hartimin e kërkesës nga avokati, fotokopjet e dokumentacionit dhe çdo shpenzim tjetër që do të kryhet deri në përfundimin e gjykimit. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkimi për shpenzimet e përfaqësimit nuk është i bazuar dhe Prokuroria e Posaçme nuk është bërë shkak i shkeljes kushtetuese.

46. Neni 28 i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj iu nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore (*pika 1*); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose

tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (*pika 2*). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (*pika 2*); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (*pika 4*).

47. Gjykata ka pohuar se individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, numrin e pretendimeve të pranuara nga Gjykata, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 57, datë 14.10.2025; nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesit Kliton Spahiu dhe Petrit Çeno i janë drejtuar personalisht Gjykatës me ankim kushtetues individual fillestar dhe në vijim kanë paraqitur parashtrime përpara seancës plenare, si dhe parashtrime shtesë në përgjigje të prapësimeve të paraqitura nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme. Ata gjithashtu kanë paraqitur një faturë tatimore të lëshuar në datën 13.02.2026 nga një përfaqësues ligjor për konsulencë dhe përpilim kërkese për Gjykatën në vlerën 90.000 lekë, si dhe një faturë për fotokopje dhe printime në vlerën 3.370 lekë.

49. Për sa më lart, Gjykata çmon se kërkimi i kërkuesve për shpenzimet gjyqësore është paraqitur brenda afatit, pasi ai është depozituar në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në lidhje me masën e shpenzimeve, Gjykata, duke marrë në konsideratë faktin se kërkuesit i janë drejtuar personalisht asaj, se gjykimi kushtetues është zhvilluar mbi bazë të dokumenteve, numrin e pretendimeve të pranuara, si dhe kompleksitetin e çështjes dhe natyrën e shërbimit juridik të dokumentuar, vlerëson të arsyeshme shpenzimet e përfaqësimit në vlerën 50.000 lekë. Gjithashtu, në kushtet kur në gjykimin kushtetues individual individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, përgjegjësia i takon vetë shtetit (*shih vendimet nr. 54, datë 09.10.2025; nr. 47, datë 18.09.2025 të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se detyrimi për pagimin e shpenzimeve të përfaqësimit duhet t’i ngarkohet Ministrisë së Financave.

50. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuesve duhet të pranohet pjesërisht, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-773, datë 14.05.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesve Kliton Spahiu dhe Petrit Çeno në vlerën 50.000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 08.10.2026

Shpallur më 10.11.2026

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesit Kliton Spahiu, Petrit Çeno dhe Petraq Dhimitri, ndonëse bashkohem me përfundimin e shumicës për cenimin e parimit të paanshmërisë, për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit E.Dh. në trupin gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, kam qasje të ndryshme në lidhje me argumentet mbi të cilat është mbështetur ky qëndrim.

2. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se gjyqtari E.Dh., i cili kishte marrë pjesë në trupin gjykues të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që kishte dhënë vendimin nr. 00-2024-3971 (543), datë 09.10.2024, në datën 31.01.2025 ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes penale të kërkuesve. Kjo kërkesë është refuzuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 25.02.2025, me arsyetimin se vetëm fakti i pjesëmarrjes së gjyqtarit në shqyrtimin e një çështjeje civile, e cila ishte prishur dhe kthyer për rigjykim, për shkak të pretendimeve të lidhura me procedimin penal objekt rekursi, nuk përbënte automatikisht shkak serioz njëanshmërie. Sipas këtij vendimi, nuk rezultonin shkaqe të përligjura që gjyqtari të ishte në pamundësi për të garantuar një gjykim të paanshëm si në aspektin objektiv, ashtu edhe në atë subjektiv, për sa kohë ai nuk kishte mbajtur qëndrim për fajësinë ose pafajësinë e kërkuesve, por kishte vlerësuar parregullsitë e procesit civil në drejtim të pretendimit për anshmërinë në dukje të gjyqtarëve, duke iu referuar ekzistencës së një vendimi gjyqësor. Po kështu, kryetari i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se arsyet serioze të njëanshmërisë nuk mund të mbështeteshin vetëm në çmuarjen ose vlerësimin e akteve dhe të provave, përveç rasteve kur i njëjti gjyqtar kishte marrë pjesë më parë, si gjyqtar ose prokuror, në shqyrtimin në themel të së njëjtës çështjeje. Në këtë drejtim, sipas vendimit, veprimtaria që mund të konsiderohej paragjykuese lidhej me një vlerësim në themel të akuzës ose të një mase ndaj lirisë personale, ndërkohë që Gjykata e Lartë ushtron kontrollin e ligjshmërisë dhe jo shqyrtimin e çështjes në themel. Për rrjedhojë, kryetari i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se pjesëmarrja e gjyqtarit E.Dh. në shqyrtimin e çështjes civile nuk përbënte shkak njëanshmërie, as në dukje, por ushtrim të funksionit të tij si gjyqtar i ligjit.

3. Shumica, pasi ka marrë në analizë pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në aspektin objektiv, është përqendruar në natyrën dhe në përmbajtjen e konstatimeve të bëra në vendimin civil, si dhe në lidhjen e tyre me rrethanat faktike të akuzës penale. Në këtë drejtim, shumica ka vlerësuar se, ndonëse Kolegji Civil nuk kishte shqyrtuar në themel akuzën penale dhe nuk kishte rivlerësuar provat e administruara në procesin penal, ai i kishte trajtuar si të vërtetuara

gjyqësisht rrethanat faktike që lidheshin drejtpërdrejt me akuzën penale ndaj kërkuesve. Duke mbajtur parasysh pjesëmarrjen e mëvonshme të gjyqtarit E.Dh. në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, shumica ka arritur në përfundimin se dyshimet e kërkuesve për paanshmërinë e tij ishin objektivisht të justifikuara dhe, për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e këtij parimi ishte i bazuar (*shih paragrafët 41-43 të vendimit*).

4. Në vlerësimin tim, në analizën e pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë shumica duhej t'i kushtonte rëndësi të veçantë faktit se gjyqtari E.Dh. kishte paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i çështjes penale. Nëpërmjet kësaj kërkese, gjyqtari ka treguar kujdesin e duhur për respektimin e garancive të paanshmërisë, duke ia nënshtruar vlerësimit të organit kompetent çështjen e pjesëmarrjes së tij në shqyrtimin e rekurseve penale, pas pjesëmarrjes së mëparshme në procesin civil. Në këtë kuptim, ai ka ndërmarrë veprimin procedural që kishte në dispozicion për të shmangur një situatë që mund të krijonte dyshime për paanshmërinë e tij.

5. Në këtë drejtim, vlerësoj se rëndësi të veçantë merr vendimmarrja e kryetarit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e kërkesës për dorëheqje. Ndonëse në vendimin përkatës është arsyetuar se gjyqtari E.Dh. nuk kishte mbajtur qëndrim për fajësinë ose pafajësinë e kërkuesve dhe se pjesëmarrja e tij në procesin civil nuk përbënte shkak serioz njëanshmërie, ky vlerësim nuk ka marrë parasysh në mënyrë të mjaftueshme rëndësinë e konstatimeve të bëra në vendimin civil për garantimin e paanshmërisë në aspektin objektiv. Sikurse ka evidentuar edhe shumica, Kolegji Civil i kishte trajtuar si të vërtetuara gjyqësisht rrethanat faktike që lidheshin drejtpërdrejt me akuzën penale ndaj kërkuesve, ndërkohë që vendimi penal nuk kishte marrë ende formë të prerë. Për rrjedhojë, vlerësimi i kërkesës për dorëheqje nuk duhej të kufizohej vetëm në përcaktimin nëse gjyqtari kishte shprehur qëndrim për përgjegjësinë penale të kërkuesve, por duhej të përfshinte edhe analizën nëse pjesëmarrja e tij në shqyrtimin e mëvonshëm të rekurseve penale mund të krijonte dyshime objektivisht të justifikuara për paanshmërinë e trupit gjykues.

6. Në këto rrethana, çmoj se cenimi i parimit të paanshmërisë ka ardhur si pasojë e mospranimit të kërkesës për dorëheqje nga kryetari i Gjykatës së Lartë, vendimmarrje që ka mundësuar pjesëmarrjen e gjyqtarit E.Dh. në shqyrtimin e rekurseve penale. Nga ana tjetër, gjyqtari E.Dh., me paraqitjen e kërkesës për dorëheqje, ka treguar kujdesin e duhur për garantimin e paanshmërisë së procesit. Për këtë arsye, vlerësoj se konstatimi i cenimit të parimit të paanshmërisë në rastin konkret duhej të lidhej me vlerësimin e bërë për mospranimin e kërkesës për dorëheqje.

7. Për sa më lart, bashkohem me përfundimin e shumicës se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të paanshmërisë është i bazuar. Megjithatë, vlerësoj se në arsyetimin e këtij përfundimi duhej të evidentohej se gjyqtari E.Dh. kishte treguar kujdesin e duhur duke paraqitur kërkesën për dorëheqje, ndërsa pjesëmarrja e tij në shqyrtimin e rekurseve penale ishte pasojë e vendimmarrjes së kryetarit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e kësaj kërkese.

Anëtare**: Sonila Bejtja**

MENDIM PAKICE

1. Unë gjyqtari Asim Vokshi, për arsyet e mëposhtme, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e pjesshëm të kërkesës së kërkuesve Kliton Spahiu, Petrit Çeno dhe Petraq Dhimitri, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda; nr. 19, datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-773, datë 14.05.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konstatimi i tejzgjatjes së procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe gjatë hetimeve paraprake, dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë ose në një nga gjykatat e faktit: Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ose Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, njohja dhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera nga kërkuesit Kliton Spahiu dhe Petrit Çeno në Gjykatën Kushtetuese.

2. Siç referon shumica në paragrafin 14 të vendimit, në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, *pasi të jenë shteruar* të gjitha *mjetet juridike efektive* për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore

kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky kriter kërkon që kërkuesi të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale *mjetet juridike efektive*, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në rast se pala di ose ka detyrimin dhe mundësinë të dijë se një shkelje procedurale (sipas perceptimit të saj) po kryhet nga gjykata, duhet ta ngrejë këtë pretendim para asaj gjykate që po i shqyrton çështjen, në mënyrë që të parandalohet shkelja dhe të shterohet prej tij mjeti efektiv për adresimin e saj. Kjo, pasi cilado palë duhet të sillet me mirëbesim në gjykim dhe të ndihmojë në parandalimin e shkeljeve procedurale, të paktën të atyre që ajo i percepton si të tilla, e jo të lërë pa kundërshtuar "gabimin", për ta përdorur më pas si shkak ankimi ndaj vendimit gjyqësor. Nëse një palë di ose duhet të dinte (bazuar në rrethanat e çështjes) se një gjyqtar ka shkaqe papajtueshmërie në gjykimin e saj, ai duhet t'i ngrejë këto pretendime nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për përjashtim të gjyqtarit nga gjykimi, pavarësisht nëse më parë, njëkohësisht ose më pas edhe vetë gjyqtari jep dorëheqjen. Ligji në këtë rast ka rregulluar shprehimisht procedurën dhe pasojat e paraqitjes së kërkesës për përjashtim gjyqtari, duke qenë kësisoj ky një mjet efektiv për parandalimin e shkeljes së mundshme, të cilën pala ka detyrimin ta shterojë para se të ankohet në Gjykatën Kushtetuese. Konkretisht, neni 19 i KPP-së, duke normuar sa më sipër, parashikon se "*1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit bëhet në seancë menjëherë pas legjitimimit të palëve. 2. Kur shkaku i përjashtimit lind ose zbulohet pas mbarimit të momentit të legjitimimit të palëve, kërkesa duhet të bëhet brenda tri ditëve nga konstatimi. Kur shkaku ka lindur ose është zbuluar gjatë seancës kërkesa e përjashtimit duhet të bëhet para mbarimit të seancës. 3. Kërkesa përmban shkaqet e provat dhe parashtrohet me akt të shkruar. Ajo paraqitet, bashkë me dokumentet, në sekretarinë e gjykatës kompetente. Një kopje e kërkesës i jepet gjyqtarit për të cilin kërkohet përjashtimi. 4. Kur nuk bëhet personalisht nga palët, kërkesa mund të paraqitet me anën e mbrojtësit ose të një përfaqësuesi të posaçëm. Në prokurë duhet të tregohen shkaqet për të cilat kërkohet përjashtimi, ndryshe ajo nuk pranohet.*". Ndërsa neni 22(1) i KPP-së parashikon se "*1. Kur kërkesa e përjashtimit është bërë nga ai që nuk e ka pasur këtë të drejtë ose duke mos respektuar afatet ose format e parashikuara nga neni 19 kur kërkesa për heqje dorë nga gjykimi i çështjes është miratuar nga kryetari, ose kur shkaqet e paraqitura janë të bazuara në ligj, gjykata që shqyrton ankimin e shpall atë të papranueshëm me vendim.*".

4. Për sa më sipër, shtrohet pyetja: a e dinin apo a kishin mundësi ta dinin kërkuesit shkakun e papajtueshmërisë së pretenduar prej tyre për gjyqtarin E.Dh, në kohën kur po shqyrtohej çështja e tyre penale nga trupi gjykues në Gjykatën e Lartë, pjesë e të cilit ishte dhe ky gjyqtar? Nga verifikimi i dosjes gjyqësore dhe sidomos i shpalljeve publike në faqen në internet të Gjykatës së Lartë, del qartë se kërkuesit ishin në dijeni të përbërjes së trupit gjykues që do shqyrtonte çështjen e tyre penale, që përbëhej nga gjyqtarët V.K. (kryesuese), M.B. (anëtare) dhe E.Dh. (anëtar). Po ashtu, kërkuesit kanë qenë aktivë në ndjekjen e ecurisë së çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë, siç provohet nga paragrafët 20, 21 e 22 të vendimit nr. 00-2025-773, datë 14.05.2025 të kësaj gjykate, ku del se kërkuesi Petraq Dhimitri i është drejtuar asaj gjykate me kërkesë me shkrim në datën 27.06.2024, për t'i bërë me dije se e ka përfunduar dënimin, kërkuesi Kliton Spahiu i është drejtuar gjykatës në datën 08.01.2025 me të njëjtën kërkesë dhe kërkuesi Petrit Çeno i është drejtuar gjithashtu me shkresë në datën 11.04.2025. Gjykata e Lartë ka planifikuar fillimisht shqyrtimin e çështjes penale në datën 29.01.2025, e cila është shtyrë për shkak se vetë gjyqtari E.Dh. ka çmuar të paraqesë dorëheqjen nga gjykimi (e cila mban datën 31.01.2025), bazuar në argumentin se kishte gjykuar më parë çështjen civile në Gjykatën e Lartë dhe kishte prishur vendimin civil të Gjykatës së Apelit Durrës, të dhënë nga kërkuesit, bazuar në faktin se këta të fundit ishin dënuar penalisht.

5. Në faqen në internet të Gjykatës së Lartë, në datën 29.01.2025, është bërë njoftimi publik, të cilin kërkuesit kishin mundësi dhe duhej ta ndiqnin (pasi rezulton se kanë qenë aktivë), duke u cilësuar se "*Shqyrtimi i kësaj çështjeje në dhomën e këshillimit shtyhet pa datë, për shkak të papajtueshmërisë së gjyqtarit E. Dhimitri.*". Nga data 31.01.2025, kur gjyqtari E. Dh. ka paraqitur dorëheqjen, e cila nuk i është pranuar nga kryetari i Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 25.02.2025, e deri në datën 14.05.2025, kur është dhënë vendimi (pas rishpalljes së datës), kërkuesit kishin çdo mundësi të interesoheshin dhe të merrnin dijeni për shkakun e papajtueshmërisë për të cilin kishte paraqitur dorëheqje një nga gjyqtarët që do të gjykonte çështjen e tyre. Ndaj pretendimi për padijeni duhej të konsiderohej i papranueshëm në gjykimin kushtetues, e rrjedhimisht të mos konsiderohej e shteruar rruga e kundërshtimit të gjyqtarit E.Dh., për të cilën nenet 19, 20, 21 e 22 të KPP-së kanë parashikuar shprehimisht një procedurë të posaçme ligjore efektive për trajtimin e pretendimit për cenimin e gjykatës së paanshme.

6. Gjykata duhej të mbante në këtë rast të njëjtin standard që mban në paragrafin 21 të vendimit kur arrin në përfundimin se, në lidhje me pretendimet për cenimin e paanësisë nga

gjyqtarja N.K. në Gjykatën e Posaçme të Apelit, kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim, ndaj ai nuk mund të merret në shqyrtim.

7. Nga ana tjetër, edhe po të konsiderohet se nuk ngrihen problematika shterimi në lidhje me paraqitjen nga kërkuesit të një kërkese për përjashtimin e gjyqtarit E.Dh., mendoj sërisht se ai gjyqtar nuk kishte asnjë shkak të qenësishëm për përjashtim nga gjykimi penal. Në çështjen Gjon Boçari *k.* Shqipërisë (*ankimi nr. 10508/02*) Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut është shprehur se: *"Lidhur me paanësinë objektive gjykata tashmë ka konkluduar se fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete, nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanësisë së tij. Ato që kanë rëndësi janë qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor. Në të njëjtën mënyrë, njohuritë e detajuara të gjyqtarit mbi çështjen nuk përbëjnë ndonjë shkak për të dyshuar mbi paanshmërinë e tij gjatë marrjes së vendimit në themel.*". Në këtë pikë, për sa i përket parimit të paanësisë së gjyqtarit në lidhje me natyrën e pretendimit të kërkuesve për vendimmarrjen e mëparshme të tij, Gjykata mund të mbante parasysh edhe jurisprudencën e gjykatave me reputacion të lartë ndërkombëtar për elaborim standardesh kushtetuese, siç është edhe Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e cila në vendimin e dhënë prej saj në çështjen Liteky et al *k.* Shteteve të Bashkuara të Amerikës [510 U. S. 540 (1994)] ka paraqitur një këndvështrim realist të parimit të paanësisë së gjyqtarit. Konkretisht, në këtë çështje Gjykata Supreme shprehet se: "*Ashtu siç gjyqtari Jerome Frank ka theksuar me forcë: "Paanshmëria nuk është naivitet. Mosinteresimi nuk duhet barazuar me pafajësinë e një fëmije. Nëse gjyqtari nuk formon gjykime për aktorët e të ashtuquajturave drama gjyqësore që zhvillohen në gjykatë, ai nuk do të mundet kurrë të marrë një vendim.*"". Në këtë vendim përcaktohet edhe se: "*Së pari, vendimet e gjykatës në vetvete, pothuajse asnjëherë nuk përbëjnë bazë të vlefshme për pretendimet e paragjykimit ose anshmërisë së gjyqtarit [...] Së dyti, mendimet që formon gjyqtari në bazë të fakteve ose ngjarjeve që verifikohen ose ndodhin gjatë procesit, apo para tij, nuk përbëjnë bazë për pretendime për paragjykim ose anshmëri, përveçse nëse ato nxjerrin në pah një favorizim ose antagonizëm të rrënjosur thellë, që mund të bëjë të pamundur gjykimin e ndershëm të çështjes.*" Me rëndësi paraqitet edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e cituar nga shumica, ku parashikohet se "pjesëmarrja e të njëjtit gjyqtar në procese civile dhe penale që lidhen me të njëjtat fakte nuk cenon domosdoshmërisht paanshmërinë, por rëndësi kanë rrethanat konkrete të çështjes dhe, në veçanti, nëse gjyqtari ka bërë më parë vlerësime për fakte që duhet t'i shqyrtojë sërish në procesin penal (*shih Fatullayev kundër Azerbajxhanit, datë 22.04.2010, §§ 138–139*)."

8. Për sa i përket kriterit të mësipërm "*nëse gjyqtari ka bërë më parë vlerësime për fakte që duhet t'i shqyrtojë sërish në procesin penal*", mjafton të thuhet se Gjykata e Lartë është gjykatë ligji dhe jo fakti, që të arrihet në përfundimin se nuk kemi cenim të parimit të paanshmërisë, pasi gjyqtari E.Dh. nuk kishte mundësi të vlerësonte faktet që lidheshin me procesin penal. Kjo del më qartë në pah nëse i referohemi vendimit nr. 00-2024-3971, datë 09.10.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, pjesë e trupës të të cilit ishte dhe gjyqtari E.Dh., ku në lidhje me shkakun e prishjes dhe kthimit për rigjykim është shënuar vetëm sa vijon:

"*123. Ky kolegj e vlerëson të drejtë pretendimin e ngritur në rekurs se anëtarët e trupit gjykues kanë pasur pengesë ligjore për të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje.*

124. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se tre anëtarët e trupit gjykues, gjyqtarët K.P., P.Dh. dhe P.Ç., kanë qenë anëtarë të trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr. 10-2015- 387 (160) datë 18.02.2015. Konstatohet se ndaj kësaj trupe gjykuese ka filluar procedimi penal për lidhje të ngushta shoqërore me të paditurin N.S. Kështu, ka rezultuar se këta gjyqtarë, gjatë kohës që çështja ka qenë në pritje për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës dhe pasi ishte caktuar trupi gjykues për gjykimin e saj, por edhe pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor në këtë gjykatë, kanë pasur takime të vazhdueshme me të paditurin N.S., kanë shkëmbyer telefonata të vazhdueshme me njëri-tjetrin dhe jo vetëm kaq, por edhe kanë udhëtuar për më tepër se dy herë jashtë shtetit të gjithë së bashku.

125. Të gjitha këto pretendime rezulton të jenë vërtetuar gjyqësish, nga ku ka rezultuar se me vendimin nr. 69, datë 29.10.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, të tre anëtarë të trupës gjykuese, gjyqtarët K.P., P. Dh. dhe P. Ç. janë deklaruar fajtorë dhe dënuar për kryerjen e veprës penale "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 319/ç e 25 i Kodit Penal.

126. Në këto kushte, ky Kolegj vlerëson se ekziston një dyshim i justifikuar te rekursuesi se vendimi i dhënë është një produkt i një procesi të dyshuar si i njëanshëm, që përbën cenimin e një prej elementeve të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor që lidhet me besueshmërinë e gjykatës për të qenë objektivisht e paanshme. Ky qëndrim buron nga praktika e Gjykatës Kushtetuese. [1].

127. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet për rishqyrtim Gjykatës së Apelit Durrës dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me tjetër trup gjykues.".

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në këtë rast ka cituar përmbledhtazi vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë dhe e vetmja konsideratë që ka shprehur vetë lidhet me dyshimin e justifikuar të rekursuesve se gjykimi i Gjykatës së Apelit Durrës ka qenë jo i paanshëm, duke mjaftuar kaq për ta prishur vendimin dhe për ta kthyer çështjen për rigjykim. Ndaj nuk qëndron aspak konstatimi i shumicës në paragrafin 42 të vendimit se "konstatimet e bëra në

vendimin civil nuk janë kufizuar vetëm në referimin e ekzistencës së një procedimi ose vendimi penal.”. Për sa rezulton të jetë shkruar në vendimin civil, nuk e bën gjyqtarin E.Dh. që të humbasë paanshmërinë e tij në gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesve, pasi në vendimin e Kolegjit Civil konsideratat e gjykatës nuk janë shprehur në mënyrë kategorike për vërtetësinë ose jo të fakteve të caktuara penale, por janë futur në lëmin e dyshimeve të cilat vënë në diskutim paanshmërinë e trupit gjykues, sipas rregullave procedurale të procesit civil. Pra, fokusi nuk ka qenë fajësia ose pafajësia e kërkuesve, pasi kjo nuk ishte e nuk mund të ishte pjesë e gjykimit civil, por fakti se me vendim penal (të ekzekutueshëm që në vitin 2020, për shkak të vendimit të GJKKO-së së Apelit) ishin konfirmuar rrethana që vinin në dyshim paanësinë e gjykatës në gjykimin e asaj çështjeje civile. Pra, fakti se kishte edhe një vendim penal të ekzekutueshëm, ishte i mjaftueshëm për cenimin e vendimit civil të Gjykatës së Apelit Durrës, meqë çështja ishte ende në shkallët e zakonshme të ankimit.

10. Në përfundim, jam i mendimit se përveç sa më sipër, edhe arsyetimi i vendimit të kryetarit të Gjykatës së Lartë i datës 25.02.2025 (*shih citimin e tij në paragrafin 40 të vendimit të Gjykatës*), me të cilin nuk është pranuar dorëheqja e gjyqtarit E.Dh., përbën një standard të pranueshëm për rastin konkret dhe është në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, ndaj edhe bazuar mbi ato argumente nuk kishte vend për cenimin e pjesshëm të vendimit penal të Gjykatës së Lartë.

Anëtar: **Asim Vokshi**